Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

DORACAK PËR BASHKËPUNIMIN NDËR KOMUNAL DHE BASHKËPUNIMIN KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

DORACAK PËR BASHKËPUNIMIN NDËR KOMUNAL DHE BASHKËPUNIMIN KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

Nëntor, 2016

Parathënie

Bashkëpunimi ndër komunal dhe komunal ndërkombëtar në Republikën e Kosovës është normuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Bashkëpunimin Ndër komunal si dhe aktet për zbatimin e këtij ligji. Po ashtu, Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale në nenin 10 ka përcaktuar se autoritetet lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë me autoritetet lokale brenda kufijve ligjor me autoritetet e njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.

Doracaku ka për qëllim t'ju ofroj sqarime organeve të komunave, zyrtarëve komunal si dhe grupeve tjera të interesit, lidhur me procesin e inicimit dhe aprovimin e bashkëpunimit ndër komunal dhe bashkëpunimin komunal ndërkombëtar.

Ky Doracak pikë referuese ka marrë kornizën ligjore për bashkëpunimin ndër komunal dhe nuk ka karakter të aktit juridik.

Ligjet e Republikës së Kosovës në mënyrë të qartë e kanë rregulluar sistemin e vetëqeverisjes lokale. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, qeverisja bëhet në bazë të parimit të subsidiaritetit që buron nga Karta Evropiane për Qeverisje lokale, kjo duke ju dhënë mundësi të shumta njësive komunale të vetëqeverisin por edhe të bashkëpunojnë me synim që shërbimet dhe nevojat e qytetarëve të adresohen në nivelin më të lartë. Në këtë Doracak ne do të përshkruajmë hapat në bazë të kornizës ligjore që mundësojnë bashkëpunimin ndër komunal dhe atë ndërkombëtar.

Lista e shkurtesave

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
BNK	Bashkëpunimi Ndër komunal
BKN	Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar
AKK	Asociacioni i Komunave të KosovësPërmbajtja

Tabela e Përmbajtjes

Parathënie

Lista e shkurtesave

1. Baza ligjore 7

1.1. Bashkëpunimi Ndër komunal 7

1.2. Bazat e bashkëpunimit ndër komunal 7

1.3. Nisma për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal 8

1.4. Procedimi i nismës për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal 9

1.5. Marrëveshje për Bashkëpunim Ndër komunal 10

1.6. Format e Bashkëpunimit 10

1.7. Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar 11

1.8. Financimi dhe mbikëqyrja 11

2. Hapat e bashkëpunimit 12

2.1. Hapi Parë 12

2.1.1. Pse dhe Si 12

2.1.2. Kualitetet dhe Efikasiteti i bashkëpunimit 12

2.2. Hapi i dytë (Vendim-marrja dhe Plani) 13

2.2.1. Plani 13

2.2.2. Objektivat, aktivitetet dhe përcaktimi i grupeve të interesit 13

2.2.3. Grupet e interesit 13

2.2.4. Plani i zbatimit të aktiviteteve 14

2.3. Hapi i tretë - Funksionaliteti 14

2.3.1. Modeli organizativ dhe personeli 14

2.3.2. Financat 15

2.4. Hapi i katërt - Vlerësimi i BNK-së 15

3. Model marrëveshja për bashkëpunimin ndër komunal dhe anekset 16

3.1. Marrëveshja për Bashkëpunimin Ndër komunal 16

Aneksi 1: Iniciativa, Miratimi dhe Autorizimi për nismën e Bashkëpunimit ndër komunal 17

Aneksi 2a: Model Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër komunal 19

Aneksi 2b: Model Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar 23

1. BAZA LIGJORE

Fusha e bashkëpunimit ndër komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në Republikën e Kosovës është ndërtuar duke marrë për bazë standardet ndërkombëtare për qeverisjen lokale të përcaktuara me Kartën Evropiane për qeverisje lokale dhe protokollet e saj. Konkretisht kjo fushë është rregulluar me ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Bashkëpunim Ndër komunal si dhe akte tjera për zbatimin e ligjit.

Këto dy akte primare dhe sekondare ndërtojnë bazën e nevojshme për bashkëpunimin ndër komunal dhe bashkëpunimin komunal ndërkombëtar në komunat e Republikës së Kosovës, si dhe aktet nënligjore, Rregullorja për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal nr. 09/2013; Rregullore për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar e dt. 18.12.2012.[1]

1.1. Bashkëpunimi Ndër komunal

Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dy ose më shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi në pajtim me parimet, format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin e lartshënuar.

Komunat e përfshira në cilën do formë të BNK veç e veç dhe bashkërisht mbajnë përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet dhe aktet juridike që rezultojnë nga bashkëpunimi në fjalë. Po ashtu komunat janë të kufizuara të ndërmarrin veprime për lidhjen e bashkëpunimit ndër komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, në rast se dalin jashtë kompetencave vetanake të përcaktuara me legjislacionin për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës. Ç'do bashkëpunim duhet të ketë për qëllim interesin e përbashkët të komunave.

1.2. Bazat e bashkëpunimit ndër komunal

Bashkëpunimi ndër komunal është i bazuar në:

1. Interesin e përbashkët lokal;
2. Ushtrimin e një ose më shumë kompetencave vetanake të komunave: Komunat për të ushtruar në mënyrë efektive kompetencat vetanake të paraparë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale mund të bashkëpunojnë, apo të adresojnë ofrimin e shërbimit përmes një institucioni të përbashkët, i cili është i themeluar si rezultat i BNK-së;
3. Vullnetin e lirë të komunave për të krijuar marrëdhënie të BNK;
4. Ndarjen e roleve dhe përgjegjësive ndërmjet komunave si dhe bashkimin e resurseve komunale për nevoja të bashkëpunimit;
5. Përmirësimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve komunale në dobi të qytetarëve. Për t'i tejkaluar këto sfida komunat mund të hyjnë në BNK.

1 Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim ndër komunal, Rregullorja për nxitjen e Bashkëpunimit ndër komunal nr. 09/2013; Rregullore për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar e dt. 18.12.2012;

1.3. Nisma për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal

Bashkëpunimi Ndër komunal	Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar
Kryetari i Komunës	Kryetari i Komunës
Së paku 1/3 e anëtarëve të Kuvendit Komunal	Së paku 1/3 e anëtarëve të Kuvendit Komunal
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Asociacioni i Komunave të Kosovës	Komuna ose institucione të tjera të huaja të vetëqeverisjes lokale
Organizatat tjera jo-qeveritare që merren me vetëqeverisjen lokale	

Nismën për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal mund ta marrin organet komunale, institucionet qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me fushën e vetëqeverisjes lokale. Hapat për marrjen e nismës për bashkëpunim ndër komunal, janë si vijon:

Ç'do nismë për themelimin e bashkëpunimit ndër komunal duhet të përmbajë:

1. Qëllimin e bashkëpunimit;
2. Kompetencat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin për komunat e përfshira në bashkëpunim;
3. Formën e bashkëpunimit;
4. Përfitimet e pritura;
5. Implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi;
6. Çështje të tjera të rëndësishme mbi themelimin e BNK të cilat duhet të jenë të njohura për institucionet dhe qytetarët e komunave përkatëse.[2]

Kryetari i komunës ka për detyrë që brenda tri javëve nga dita e parashtrimit të nismës të ofroj Kuvendit të Komunës mendimin e tij me shkrim dhe të arsyetuar lidhur me iniciativën apo propozimin në fjalë, nëse nismën e ka parashtruar vet kryetari i komunës. Ç'do iniciativë për BNK duhet të dërgohet në Kuvendin e Komunës për miratim me shumicë të votave të anëtarëve të kuvendeve të komunave përkatëse.

2 Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim ndër komunal; Rregullorja për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal nr. 09/2013; Rregullore për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtarë e dt. 18.12.2012;

1.4. Procedimi i nismës për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal

Kuvendi i Komunës e shqyrton nismën së bashku me mendimin e kryetarit të komunës dhe merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të KK, mbi nevojën e vendosjës së BNK në pajtim me ligjin në fuqi.

Kuvendi i Komunës ka për detyrë të mbaj një seancë të hapur për shqyrtimin dhe marrjën e vendimit lidhur me nismën. Seanca në fjalë duhet të mbahet brenda 90 ditëve nga paraqitja e nismës dhe për këtë duhet t'i informoj palët e interesuara.

Nëse Kuvendi i Komunës e miraton nismën për themelimin e BNK, atëherë kuvendi me vendim e autorizon kryetarin e komunës për t'i filluar konsultimet me komunën/at gjegjëse për pjesëmarrjen e tyre në bashkëpunim dhe në bazë të këtyre konsultave ta përgatis propozim-marrëveshjen për themelimin e BNK.

Në rast se Kuvendi i Komunës e miraton nismën, atëherë ai me vendim e autorizon kryetarin e komunës që të përfaqësojë komunën gjatë bisedimeve për arritjen e marrëveshjës për BNK.

Nëse arrihet marrëveshja e bashkëpunimit ndër komunal e njëjta nënshkruhet nga kryetarët e komunave dhe miratohet nga kuvendet e komunave që janë pjesëmarrëse në bashkëpunimin ndër komunal.

Marrëveshja e bashkëpunimit ndër komunal (të brendshëm) bëhet e plotëfuqishme pas vlerësimit të ligjëshmerisë së saj nga ana Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit të marrëveshjes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

1.5. Marrëveshje për Bashkëpunim Ndër komunal

Pikat kryqe të një marrëveshje	
Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër komunal	**Marrëveshjet e bashkëpunimit komunal ndërkombëtarë**
Palët kontraktuese	Palët kontraktuese
Lënda kryesore e marrëveshjes, qëllimi dhe afati kohor	Qëllimi i marrëveshjes
Të drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshira në marrëveshje	Afati kohor
Forma ligjore e bashkëpunimit dhe burimet e financimit të buxhetit	Të drejtat dhe detyrimet
Kushtet për tërheqje nga marrëveshja dhe shkëputja e marrëveshjes	Burimet financiare për realizimin e bashkëpunimit
Procedura e zgjidhjes së konfliktit eventual	Kushtet e tërheqjes dhe shkëputjes së kontratës
Hollësi të tjera të marrëveshjes në bazë të pajtimit të palëve.	Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

1.6. Format e Bashkëpunimit

Komunat e Kosovës në bazë të Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal mund të zhvillojnë këto forma të bashkëpunimit:

- Komunat mund të formojnë grupe dhe komisione të përbashkëta punuese të përkohshme apo të përhershme për shqyrtimin e çështjeve të caktuara në kuadër të kompetencave që kanë. Përgjegjësitë, detyrimet dhe obligimet e këtyre grupeve/komisioneve janë të rregulluara në bazë të marrëveshjeve më të cilat formohen.
- Komunat mund të formojnë organe të përbashkëta administrative, për të ushtruar kompetencat e tyre të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Organet e përbashkëta administrative nuk janë subjekte juridike dhe si rezultat të gjitha veprimet dhe aktet që dalin në bazë të marrëveshjes përmes së cilës është themeluar, konsiderohen akte të komunave që i kanë themeluar.
- Komunat mund të themelojnë ndërmarrje të përbashkëta publike për të kryer shërbime publike lokale. Kjo formë e bashkëpunimit duhet të jetë në përputhje më “Ligjin për Ndërmarrjet Publike”.
- Komunat mund të themelojnë institucione të përbashkëta publike me qëllim të kryerjes së veprimtarive të caktuara me interes publik dhe me rëndësi lokale nga këto fusha; arsim, kulturë, shëndetësi, mbrojtje sociale si the fusha të tjera që janë në kuadër të kompetencave vetanake të Komunave.
- Komunat për qëllim të zhvillimit të projekteve më rëndësi komunale, ato mund të lidhin marrëveshje ndër komunale për partneritet publiko-privatë ashtu siç është përcaktuar me ligjin përkatës për partneritet publiko-privat.

1.7. Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar

Komunat e Republikës së Kosovës në kuadër të kompetencave të tyre vetanake, për nevojat e bashkëpunimit administrativë dhe teknik mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me komuna dhe institucione të huaja të vetëqeverisjes lokale në pajtim me parimet, kushtet, kufizimet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Procedurat që duhet ndjekur lidhur me bashkëpunimin komunal ndërkombëtarë është përcaktuar në Rregulloren për procedurën e bashkëpunim komunal ndërkombëtar (18.12.2012).

Në kuadër të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar , komunat nuk kanë të drejtë të heqin dorë nga kompetencat e tyre të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Komunat nuk mund t'i delegojnë një komune apo autoriteti publik të huaj për ushtrimin e kompetencave të veta apo të njëjtës t`ia lejojnë ushtrimin e çfarëdo pushteti vendimmarrës, ekzekutiv dhe administrativë, në territorin e Republikës së Kosovës.

1.8. Financimi dhe mbikëqyrja

Komunat përmes BNK zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe kanë si mundësi për t'i mbështetur financiarisht këto iniciativa përmes këtyre burimeve financiare:

- Përmes buxhetit të Republikës së Kosovës dhe ministrive të fushave përkatëse.
- BNK mund të financohen nga buxhetet e Komunave të cilat përmes një marrëveshje të qartë i kanë të caktuara përgjegjësitë e tyre financiare.[3]
- Komunat që janë në bashkëpunim ndër komunal mund të aplikojnë për mbështetje financiare tek donatorët ndërkombëtar, përfshirë edhe fondet e BE-së.

MAPL-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, përcjellë zhvillimin e bashkëpunimit ndër-komunal si dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve financiare të dedikuara për zbatimin e BNK sipas legjislacionit në fuqi.

3 Sa i përket buxhetit, ç'do bashkëpunim ndër komunal dhe bashkëpunim komunal ndërkombëtar duhet zbatohet duke respektuar ligjin për menaxhimin e financave publike, ligjin për prokurim publik si dhe legjislacionin sekondar që vjen si rezultat i ndonjë rregullore të brendshme apo udhëzimi administrativë. Sa i përket linjave buxhetore ato duhet të rregullohen sipas praktikave që i kanë komunat, gjithmonë në harmoni me udhëzimet/qarkoret buxhetore që vijnë nga Ministria e Financave.

2. HAPAT E BASHKËPUNIMIT

BNK realizohet në bazë të kritereve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, që pasqyrojnë format e suksesshme të bashkëpunimit përmes respektimit të parimeve: efektshmëria dhe cilësia e shërbimeve, qeverisja e mirë, proceset integruese dhe përfitimi i fondeve.

2.1. Hapi Parë

2.1.1. Pse dhe Si

Para së të fillojë BNK, është më rendësi të dihet se pse po e ndërtoni këtë bashkëpunim. Cila është nevoja e cila e shtyn komunën që ju përfaqësoni që të adresoj këtë problem përmes BNK-së. Në këtë kontekst është më rëndësi të kuptohet qëllimi i bashkëpunimit, dhe para qëllimit të kuptohet mirë ku qëndrojnë problemet dhe sfidat që mund të adresohen përmes këtij bashkëpunimi. Para ç'do bashkëpunimi komunat duhet të analizojnë në thellësi problemet apo çështjen që dëshirojnë të adresojnë përmes bashkëpunimit.

Në këtë kontekst është mirë që të shfrytëzohen burimet e tjera si nga sektori privat, apo ai i shoqërisë civile. Vetëm nëse analizohet si duhet problemi dhe të konstatohen sfidat e sakta që dalin nga BNK, atëherë BNK mund të zbatohet . Pastaj është me rendësi të analizohen kapacitet financiare dhe humane të nevojshëm për adresimin e çështjes/problemit të identifikuar. Vetëm atëherë Komunat e Republikës së Kosovës e kanë kuptuar pse është i nevojshëm bashkëpunimi, dhe si do të behët ai, rekomandohet që të zhvillojnë këtë bashkëpunim.

2.1.2. Kualitetet dhe Efikasiteti i bashkëpunimit

Kualiteti dhe efikasiteti i BNK varet kryesisht se si rregullohet marrëveshja e bashkëpunimit. Sa janë të qarta përgjegjësitë që kanë, dhe se ndarja e përgjegjësive është bërë konform kapaciteteve që kanë komunat për ta realizuar BNK-në. Plani i zbatimit të bashkëpunimit dhe mekanizmat e monitorimit janë të domosdoshme.

2.2. Hapi i dytë (Vendim-marrja dhe Plani)

2.2.1. Plani

Komunat pasi të kenë të qartë problemin ata duhet të ndërtojnë projekte dhe plane konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e çështjeve me rendësi. Në varësi prej problemeve/çështjeve që mund adresohen, komunat duhet të zhvillojnë një projekt propozim apo plan konkret, me aktivitete konkrete duke u bazuar me një plan kohor për zbatimin e tyre. Pjesë e propozimit duhet të jetë: qëllimi i bashkëpunimit, objektivat, aktivitetet dhe ndarja e përgjegjësive në kuadër të BNK-së.

Në rast se bashkëpunimi përfshin themelimin e ndonjë ndërmarrje publike atëherë pjesë e projekt propozimit duhet të jetë një planë i biznesit që adreson aspektin e kostos/përfitimit ekonomik, si dhe përfitimet që dalin nga themelimi i ndërmarrjes publike. Është më rendësi të theksohet se për themelimin e ndërmarrjeve publike duhet të respektohen procedurat që burojnë nga Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.



Struktura e një propozimi

2.2.2. Objektivat, aktivitetet dhe përcaktimi i grupeve të interesit

Objektivat e BNK paraqesin bazën për aktivitetet që do të zhvillohen gjatë bashkëpunimit komunat duhet të kenë të qartë se përmes cilave aktivitete do të arrihen objektivat dhe qëllimi i realizimit të bashkëpunimit dhe të njëjtat duhet të jenë të harmonizuara dhe të zbatueshme, pasi që ç'do aktivitet i mbivlerësuar apo i pa zbatueshëm mund të jetë rrezik për tërë BNK-në. Përcaktimi i grupeve të interesit është më rendësi, pasi BNK-ja bëhet për të adresuar nevojat e qytetarëve, bizneseve apo institucioneve.

2.2.3. Grupet e interesit

Në kuadër të BNK-së ç'do autoritetet apo individ duhet t'i dijë përgjegjësit që ka kundrejt marrëveshjes për bashkëpunim. Ç'do aktivitet që planifikohet duhet të këtë të caktuar personin/zyrtarin i cili është i obliguar që të zbatoj atë aktivitet.

2.2.4. Plani i zbatimit të aktiviteteve

Ky plan duhet të shtrihet në bazë të vitit kalendarik, me periudha të qarta kohore në të cilat do të zbatohen projekte të ndryshme. Në këtë Doracak do të kemi një ilustrim të versionit të thjeshtëzuar.

Aktiviteti	Janari				Shkurt				Mars				Prill				Maj				Përgjegjes
Aktiviteti 1																					X
Aktiviteti 2																					XC
Aktiviteti 3																					YX
Aktiviteti 4																					XX
Aktiviteti 5																					YY
Aktiviteti 6																					Y

2.3. Hapi i tretë - Funksionaliteti

2.3.1. Modeli organizativ dhe personeli

Në varësi të bashkëpunimit komunat duhet të ndërtojnë një model të organizimit i cili merret me zbatimin e bashkëpunimit. Struktura apo hierarkia duhet të ndërtohet në bazë të kompetencave që kanë komunat, apo në bazë të marrëveshjes që nënshkruajnë për ndarjen e përgjegjësive. Për derisa respektohet parimi i ligjshmërisë (kompetencat që kanë komunat) dhe se modeli organizativë është i qartë, atëherë BNK-ja mund të jetë e suksesshme. Llogaridhënia është pjesë e rëndësishme e ç'do marrëveshje pasi që komunat të cilat hyjnë në BNK kanë obligim që t'i informojnë qytetarët për proceset nëpër të cilat po kalon komuna përmes BNK-së.

Personat që marrin pjesë në këtë bashkëpunim, pavarësisht a janë nëpunës civil apo të kontraktuar vetëm për zbatimin e bashkëpunimit duhet të jenë të përzgjedhur në mënyrë profesionale për mes procesit të konkursit të brendshëm apo të jashtëm duke u bazuar në parimin e meritokracisë.



2.3.2. Financat

Financat duhet të jenë pjesa më e rëndësishme që duhet të diskutohen në fillim të inicimit të BNK-së. Është mirë që në fillim pavarësisht informatave të limituara të krijohet së paku një draft buxhet me koston e mundshme të bashkëpunimit. Duhet të diskutohet për mënyrën se si do të ndërtohet buxheti, burimi i financave si dhe kontributin financiar që do të japin komunat veçmas për realizmin e bashkëpunimit. Pasi që janë të përcaktuar të gjitha aktivitetet, bëni vlerësimin realë të kostos për secilin aktivitet. Bëhuni kreativ në përllogaritjen e kostos dhe mundohuni që të parashikoni shpenzime që mund të jenë të fshehura, që në rast të identifikimit me vonës mund të shkaktojnë probleme në implementim të bashkëpunimit.

2.4. Hapi i katërt - Vlerësimi i BNK-së

Komunat duhet të vendosin se me cilin model dëshirojnë të vlerësojnë se sa i suksesshëm është apo ka qenë BNK-ja. Në këtë kuptim komunat duhet të pajtohen që para se të fillojë bashkëpunimi, se a do të bëjnë një gjë të tillë në mënyrë të vazhdueshme gjatë zbatimit të projektit, apo përmes një vlerësimi final. Është e preferuar që vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit të bëjë një palë e tretë e cila nuk ka qenë e involvuar në projektin e bashkëpunimit.

3. MODEL MARRËVESHJA PËR BASHKËPUNIMIN NDËR KOMUNAL DHE ANEKSET

3.1. Marrëveshja për Bashkëpunimin Ndër komunal

Marrëveshja për themelimin e bashkëpunimit ndër komunal përmban të paktën elementet vijuese, në bazë të legjislacionit për bashkëpunim ndër komunal:

- Palët kontraktuese;
- Lëndën kryesore të marrëveshjes, qëllimin dhe afatin e saj kohor;
- Të drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshirë në marrëveshje;
- Formën ligjore të bashkëpunimit dhe burimet e financimit dhe buxhetit;
- Kushtet për tërheqje nga marrëveshja dhe shkëputjen e marrëveshjes;
- Procedura e zgjidhjes së konflikteve eventuale;
- Hollësitë tjera të marrëveshjes ashtu siç janë pajtuar palët/komunat partnere.

Aneksi 1: Iniciativa, Miratimi dhe Autorizimi për nismën e Bashkëpunimit ndër komunal
Aneksi 2a: Model Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër komunal
Aneksi 2b: Model Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar

Aneksi 1: Iniciativa, Miratimi dhe Autorizimi për nismën e Bashkëpunimit ndër komunal

LOGO E KOMUNËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal, **Kryetari i Komunës** paraqet kërkesë për miratimin:

NISMËN

PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNËN/AT

NË FUSHËN _____

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me komunën/komunat si në vijim:

   1.1. Komunës së _____,

   1.2. Komunës së _____,

   1.3.

2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën _____, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e _____. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.

3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim - vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës.

4. **Arsyetimi** -

02. Nr._____

Komuna,_____

Kryetari i Komunës

_____

(emri dhe mbiemri)

LOGO E KOMUNËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

Në pajtim me nenin 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal, **Kuvendi i Komunës së** _____, miraton:

VENDIM

1. Miratohet nisma e Kryetarit/es të Komunës së _____ për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal.

2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim:

   2.1 _____

   2.2 _____

3. Autorizohet kryetari/ja i/e komunës për të filluar konsultimet me komunat për përgatitjen e propozim marrëveshjes; për bashkëpunim ndër komunal.

4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së _____.

01. Nr._____

Komuna,_____

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

_____

(emri dhe mbiemri)

Aneksi 2a: Model Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër komunal

LOGO E KOMUNËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT NDËR KOMUNAL

Palët nënshkruese të marrëveshjes

Komuna _____

dhe

Komuna _____

Kanë rënë dakord mbi arritjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndër komunal në fushën e_____ _____

DUKE KONSIDERUAR që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve _____ _____,

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim ndër komunal dypalësh (*ose shumë palësh nëse ka më shumë palë në marrëveshje*) mbi baza të drejta.

DUKE JU REFERUAR Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 (k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndër komunal Nr. 04/L-010, Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75.

Neni 1

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale

Nr. 03/L-040 neni 17(k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndër komunal Nr. 04/L-010 Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75.

_____

_____

Neni 2

QËLLIMI

Qëllimi i bashkëpunimit është: _____

_____

_____

Qëllimi i marrëveshjes është që të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç .

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm.

Neni 3

LËNDA E MARRËVESHJES

Lënda e kësaj marrëveshje është:

Neni 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SECILËS PALË TË PËRFSHIRË NË MARRËVESHJE

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së _____.

1._____,

2._____,.

3._____.

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së _____.

1._____,

2._____,.

3._____.

Neni 5

BURIMET E FINANCIMIT

Neni 6

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët në këtë marrëveshje janë pajtuar për formimin e grupit të përbashkët punues për zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 7

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

1. Ç'do mosmarrëveshje mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim, arbitrazh dhe përmes gjykatës kompetente.

Neni 8

HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit ndër komunal bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale dhe publikimit të marrëveshjes në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kjo marrëveshje është hartuar në _____kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga _____ kopje.

Komuna, datë_____

Komuna e _____ Komuna e _____

_____ _____

Aneksi 2b: Model Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

(Palët nënshkruese)

(*Ligji Nr. 04/L- 010 për bashkëpunim ndër-komunal neni 8*)

ndërmjet

Komunës së _____ (qyteti) në Republikën e Kosovës

dhe

Komunës së _____(qyteti) në _____(shteti)

për bashkëpunim në fushën

"_____"

(T I T U LL I)

DUKE KONSIDERUAR që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve _____ _____,

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim dypalësh (*ose shumë palësh nëse ka më shumë palë në*

marrëveshje) mbi baza të drejta .

DUKE JU REFERUAR Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 neni 17(k) dhe 30 ,Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal Nr .04/L-010, Ligji për arbitrazhin Nr. 02/L-75

Kanë rënë dakord mbi arritjen e kësaj marrëveshje bashkëpunimi të mëposhtme :

(Lënda kryesore e marrëveshjes, qëllimi)

(Ligji Nr .04/L- 010 për bashkëpunim ndërkomunal neni 8)

Neni 1

QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi është: _____
_____
_____
_____

2. Të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç .

3. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm .

(Forma ligjore e bashkëpunimit burimet e financimit dhe buxhetit)

(Ligji Nr. 04/L- 010 për bashkëpunim ndërkomunal neni 8)

Neni 2

FORMAT E BASHKËPUNIMIT (APO FUSHAT E BASHKËPUNIMIT)

_____

_____
_____

Neni 3

(Te drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshirë në marrëveshje)

(*Ligji Nr. 04/L- 010 për bashkëpunim ndërkomunal neni 8*)

1. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së _____.

   1.1. _____,

   1.2. _____,

   1.3. _____.

2. Të drejtat dhe detyrimet e (_____) qyteti (shteti) _____

   2.1. _____,

   2.2. _____,

   2.3. _____.

Neni 4

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes në fjalë .

(Hollësitë tjera të marrëveshjes ashtu siç janë pajtuar palët/komunat partnere)

(*Ligji Nr. 04/L- 010 për bashkëpunim ndërkomunal neni 8*)

Neni 5

DETYRIME TJERA

1. Palët marrin masat e nevojshme për të realizuar veprimtaritë në të gjitha fazat e ndërtimit nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe nënshkrimit të akteve tjera të mëvonshme që dalin nga ky bashkëpunim reciprok e që kanë të bëjnë me _____.

2. Palët caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit të përcaktuar me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

(Kushtet për tërheqje nga marrëveshja dhe procedura e zgjidhjes së konflikteve eventuale)

(*Ligji Nr. 04/L- 010 për bashkëpunim ndërkomunal neni 8*)

Neni 6

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të qëndroj deri _____(nëse janë marrë vesh për afatin)

2. Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamentimi do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.

3. Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ,menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me negociata dhe nëse është e nevojshme me anë të ndërmjetësimit ose arbitrazhit. (***"Marrëveshja e Arbitrazhit" nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile-juridike dhe ekonomike-juridike mund t'i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse është e ndaluar me ligj.)***

4. Kjo marrëveshje është hartuar në _____kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga _____ kopje.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje .

Komuna e _____ Komuna e _____

_____ _____

DORACAK PËR BASHKËPUNIMIN NDËR KOMUNAL DHE
BASHKËPUNIMIN KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

HELVETAS
Swiss Intercooperation
KOSOVO

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo